AKTUALITET KRYESORE TË FUNDIT

Detaje nga vrasja në Sukth/ Viktima emër i njohur për policinë, vëllai në burg, larje hesapesh pista kryesore e hetimit

27/09/2023 09:14

Detaje të reja kanë dalë në dritë nga vrasja e Fatjon Dervishit në Sukth të Durrësit.

Ai u qëllua në zonën e shinave pranë fshatit Katund. Sipas gazetares Dorjana Bezat, dyshohet se autorët e kanë ndjekur nga lokali ku ishte deri tek shinat, ku mjeti uli shpejtësinë dhe më pas hapën zjarr drejt 38-vjeçarit duke e plagosur rëndë.

Më pas Dervishi humbi jetën në spital, ndërsa shoku i tij nuk mori lëndime.

Fatjon Dervishi është emër i njohur për policinë sepse ka qenë i skeduar për drogë dhe krime ndaj personit e pronës, por asnjëra prej këtyre nuk i është provuar. Ndërkohë vëllai i viktimës, Fatbardh Dervishi ndodhet në burg.

Mësohet se veç mbiemrit Dervishi, vëllezërit mbanin edhe mbiemrin Doda.

Vëllai i viktimës ka qenë i përfshirë në një grup kriminal në Spanjë, ku është dënuar për pastrim parash. Sipas informacioneve, ai dyshohet gjithashtu për zhdukjen e një personi në Spanjë. Në vitin 2018 Fatbardh Dervishi dyshohet se ka zhdukur personin e identifikuar si Tauland Malshi.

Në ditët e para të vitit 2022, Fatbardh Dervishi plagosi të dashurën 23-vjeçare nga Durrësi në një dhomë hoteli teksa po festonin së bashku vitin e ri. Pas plagosjes në hotel 32-vjeçari u largua nga vendi i ngjarjes. Në atë kohë e plagosura e shfajësoi Dervishin duke deklaruar se ishte një ngjarje pa dashje, po në gjykatën e Durrësit vijon gjykimi ndaj tij për plagosje të lehtë.

Aktualisht ai ndodhet në burg për këtë vepër penale dhe për dënimin që mori në Spanjë. Sipas informacioneve, deri më tani larja e hesapeve është pista kryesore ku po heton policia.

Gjashtë persona janë shoqëruar nga policia e Durrësit në funksion të zbardhjes së vrasjes që ndodhi natën e kaluar në Katund të Sukthit.

Policia po vijon me intensitet hetimet, ndërsa po këqyren edhe pamjet e kamerave të sigurisë në mënyrë që të kuptohen lëvizjet e viktimës dhe autorit.

38-vjeçari Fatjon Dervishi u qëllua natën e kaluar ndërsa po kthehej me makinë në shtëpi bashkë me shokun e tij, pasi kishin qëndruar në një lokal.

Kontrolle të shumta janë ushtruar në të gjithë zonën përreth dhe në hyrje-daljet e autostradës. Në ndihmë të policisë së Durrësit kanë mbërritur edhe dy grupe të FNSH-së Tiranë.

Grupi hetimor po vijon veprimet për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes, me qëllim identifikimin dhe kapjen e autorit dhe bashkëpunëtorëve të tij në këtë krim. Errësira në zonë nuk ka ndihmuar për të dhënë detaje që do të ndihmonin zbardhjen e shpejtë të ngjarjes.

FOTO GALERI 1/13



Top Channel

Aktualitet »

Apeli lë në fuqi vendimin e GJKKO-së, 2 vite e 4 muaj burg për ish-shefin e Krimeve të Elbasanit, Leonard Palushi
27/09 10:23

Fier/ Sekuestrohen 3100 fara kanabis, një 50-vjeçar në pranga, i nipi nën hetim
27/09 10:12

Do trafikonte 52.6 kg kanabis jashtë Shqipërisë, në pranga një 45-vjeçar në Korçë
27/09 09:51

Kultivim kanabis në Vaun e Dejës, në pranga një 38-vjeçar dhe bashkëshortja e tij nën hetim
27/09 09:25

Pas trotuarëve të rinj në "Mylsym Shyri", instalohen dhe vendqëndrimet për biçikletat
27/09 09:09

Atentati ndaj Fatjon Dervishit në Sukth/ Vijojnë hetimet, shoqërohen në polici gjashtë persona
27/09 08:55

Kryesore »

Apeli lë në fuqi vendimin e GJKKO-së, 2 vite e 4 muaj burg për ish-shefin e Krimeve të Elbasanit, Leonard Palushi
27/09 10:23

UNESCO zbulon site të reja të trashëgimisë botërore
27/09 10:18

Fier/ Sekuestrohen 3100 fara kanabis, një 50-vjeçar në pranga, i nipi nën hetim
27/09 10:12

Analistja amerikane: Putin dhe Vuçiç po qeshin, do të testojnë sërish NATO-n në Ballkan
27/09 10:02



Do trafikonte 52.6 kg kanabis jashtë Shqipërisë, në pranga një 45-vjeçar në Korçë
27/09 09:51

Kultivim kanabis në Vaun e Dejës, në pranga një 38-vjeçar dhe bashkëshortja e tij nën hetim
27/09 09:25

Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

Video »

Top News – Serbët ndërojnë terroristët e vrarë në Manastir/ Kreu i Listës Serbe puth fotot e viktimave

Top News – Biden, i pari president që "futet në grevë" / Presidenti i SHBA kërkon rritje page

Top Channel/ Kultivim kanabis në Vaun e Dejës, arrestohet një 38-vjeçar, bashkëshortja nën hetim

Top News – Ekzekutohet nipi i 'Arapit të Sukthit'/Viktima u qëllua me breshëri, shpëton shoku i tij

Top Channel/ Detaje nga vrasja në Sukth! Vëllai i viktimës në burg, pista e hetimit larje hesapesh

Orjani i prish takimin Saides me Robertin, ajo largohet nga studio – Ep.7 Përputhen 26/09/2023



Kryesore

Vrasja e Martin Bardhit ende pa autor/ Shoqërohen në komisariatin e Lezhës anëtarë të fisit Reçi
08:47

Riten temperaturat! Moti me vranësira dhe kthjellime të herëpashershme
08:04

Kultivim kanabis në Vaun e Dejës, në pranga një 38-vjeçar dhe bashkëshortja e tij nën hetim
09:25

BE, me plan të ri për integrimin dhe rritjen ekonomike të Ballkanit Perëndimor
09:54

Më të lexuarat

Fotot/ Angli, grabisnin të veshur si policë, dënohen shqiptarët! Të përfshira edhe të dashurat e tyre

Vrasje në Durrës/ Qëllohet për vdekje 38–vjeçari në rrethana të paqarta (Emri)

Fiks Fare/ Emërime nepotike në Bashkinë e Kavajës, Oosja punëson djalin e tezes, dhëndrin, krushkën në poste kyçe!

Para pak ditësh kishte dalë nga burgu, ky është Martin Bardhi që u vra sot në Rrëshen

Pesë mënyra natyrale si të luftoni stresin, lodhjen dhe pagjumësinë

Dhjetëra automjete të KFOR-it nisen në drejtim të Leposaviqit

Miss Zimbabve është e bardhë, protesta në rrjetet sociale: "Ajo nuk na përfaqëson. 98% e popullsisë është me ngjyrë"

Konfirmohen zyrtarisht katër anëtarët e jurisë së Dancing With the Stars!

Modelja bleu makinë sportive duke shitur foto erotike por pendohet prej talljeve në rrjet (fotot)

Trafiku në Tiranë/ Çdo mjet i parkuar gabim do të hiqet me karoatrec dhe do të bllokohet

© Top Channel 2001 - 2023 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.